

Procesverbal

*Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
10.02.2025*

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2) Anulimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ZK Dragash P-70604014-00099-1 me pronën e përbashkët të z.Amir (Ahmet) Jamini, z.Asad (Ahmet) Jamini, Rehjan (Omer) Jamini dhe Nerkes (Omer) Jamini, prona me numër të parcelës P-70604014 - 00827 - 2 ZK Dragash;
- 3) Raporti Financiar Tetor-Dhjetor 2024 (Tremujori i katërt i vitit 2024);
- 4) Raporti Vjetor Financiar për vitin 2024;
- 5) Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025;
- 6) Raporti i Punës i KKSB-së për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025; dhe
- 7) Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e parë të rregullt për vitin 2025! Ju dëshiroj punë të mbarë për këtë vit! Uroj që të dalim me performancë sa më të mirë edhe këtë vit, siç kemi dalë edhe vitin e kaluar. Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Në këtë seancë kemi gjashtë pika të rendit të ditës dhe pikën eventuale, siç e keni pranuar në ftesë. Ju lutem, nëse do dikush me diskutue vetëm rreth rendit të ditës.

Shpetim Hajredini: Faleminderit! Përshëndetje, të nderuar kolegë, ekzekutiv, qytetarë të nderuar të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! Natyrisht, deshta të ndërlidhem me një problem, një çështje të cilën shumë herë na e kemi diskutue këtu, por fatkeqësisht kjo nuk po merret parasysh prej ekzekutivit, dhe tani edhe prej kryesueses, që kam prit që nuk do të bëjë një tolerim të tillë. Materiali elektronik neve na ka ardhë të gjithëve, besoj. Neve këtu na është premtue nga ish-drejtori i Administratës – po besoj që është hala drejtor dhe vazhdon të jetë - na është premtu që neve do të na vijë edhe materiali fizik i çdo seancës, me përjashtim të procesverbalit. Po më vjen shumë keq që, së paku, mosprezantimi i tij, juve, të kishit pas pak ndërgjegje dhe mos të ia qitni poshtë atij premtimin e tij dhe të kishit vazhdue të na kishit pru neve materialin edhe në formë fizike, jo vetëm në formë elektronike. Por fatkeqësisht, nuk po e keni problem ju këtë çështje. Tjetra për të cilën deshta të ndërlidhem tani menjëherë, para se me e fillue seancën, unë e di që kjo

datë është data e fundit dhe duhet patjetër të mbahet seanca, për t'i marrë rrogat na, por keni pas mundësi edhe në ditët e mëhershme të na dërgoni edhe ta mbajmë më herët. Dje i kemi pas zgjedhjet, të gjithë jena, unë besoj, këtu prej nesh, të lodhur. Kemi ndejt deri vonë, kemi prit rezultatet, dihet çka ka ndodhë. Dhe sot – unë jam i bindur vetë, personalisht, realisht nuk jam as 50% i gatshëm të diskutoj, por edhe të tjerët jam i bindur që e kanë potencialin e njëjtë si unë, janë të shterrur. Andaj, kishte qenë mirë që kjo seancë të mos mbahet sot, por ju na keni pru dhe natyrisht ne patjetër e kemi që ta mbajmë dhe ta vazhdojmë deri në fund. Edhe një pikë tjetër, po besoj që është më mirë ta lë në eventuale, mos të marr kohë ma shumë për këtë çështje. Në eventuale kam të drejtë ta diskutoj. Ju faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Unë pajtohem plotësisht me shefin e Grupit, me Shpetimin, se jemi shumë të lodhur. Por unë e kam edhe një problem tjetër, e kam diskutue me ju edhe me kryetarin. Problemin e mediave lokale. Qytetarët janë të shqetësuar si edhe unë, që në seancën e fundit nuk është transmetue pjesa e dytë e seancës. Andaj, kërkoj nga jus i kryesuese, edhe nga kryetari, që të shtihet pikë e rendit të ditës, të diskutohet, të shohim a kemi kontrata, kush ka kontrata, pse nuk është bërë kjo gjë, këtë çështje me e qit, qytetari me e ditë, se shumë qytetarë janë ankue – nuk dona, për shembull, me e pa Radio Sharrin, dona me e pa TV Opojën – edhe asambleistat, mungon seanca, pjesa e dytë e seancës mungon në rrjetet sociale. Unë kam qef këtë pikë me e shti si pikë të rendit të ditës, me diskutue, se mundësinë e kam në eventuale, por do të ishte më mirë të jetë pikë e rendit të ditës. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë, Shpetimi kërkoi që kopjet fizike t'ju sillen. Edhe unë kisha kërkue prej kryetarit që kopjet fizike t'u dërgohen të gjithë asambleistëve, siç edhe është premtime, siç e tha edhe z.Hajredini. Kishte dhe një kërkesë nga z.Artan Loshaj, për mediat pse s'e kanë qit pjesën e dytë të Kuvendit. A doni në pikën eventuale me u diskutue apo me e qit si pikë të rendit të ditës? Atëherë, të nderuar asambleistë, kërkesa e Artan Loshajt ishte rreth mediave. Kush është pro që kjo pikë të futet në rend të ditës, si pikë e veçantë? A ka kundër? Abstenim? Me 8 vota pro, 12 kundër dhe zero abstenim, nuk futet kjo në rend të ditës.

Driton Ademi: Unë e kam një çështje, që Ademi është mirë me i ngjeh votat shumë ma mirë. Nuk është hera e parë kjo që po bën vaki në këtë Kuvend, që votat nuk janë duke u ngjeh mirë. Domethënë, Samidini – më fal Samidin që po ta përmendi emrin – ka qenë me krye teposhtë, nuk ka votue as pro e as kundër, as abstenim. Kjo nuk është hera e parë, është hera e disat që ju jeni

duke e manipulue këtë proces. Është mirë me u çue në këmbë edhe me i ngjeh votat, ose mos e manipuloni procesin, jo me 12, jo me 13, jo po kalohet, e jo s'po kalohet. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, kush është pro rendit të ditës, siç e keni marrë në Thirrje? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, me 13 kundër, më lejohet edhe vota ime. Kështu që, unë jam pro. Me 14 pro, 13 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë te pika e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë: Anulimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ZK Dragash P-70604014-00099-1 me pronën e përbashkët të z.Amir (Ahmet) Jamini, z.Asad (Ahmet) Jamini, Rehjan (Omer) Jamini dhe Nerkes (Omer) Jamini, prona me numër të parcelës P-70604014 - 00827 - 2 ZK Dragash. A do dikush me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 13 kundër, prapë shfrytëzoj votën e 14-të pro anulimit të Vendimit. Vazhdojmë me pikën e tretë: Raporti Financiat Tetor-Dhjetor 2024 (Tremujori i katërt i vitit 2024). A do dikush me e marrë fjalën?

Shpetim Hajredini: Edhe pse raportet gjithmonë e kam thënë që janë bartje të atyre që kanë ndodhur gjatë këtyre muajve, edhe diskutimet janë, ta them, jo të kota, por jo që ndikojnë diçka në të mirë të qytetarëve, pasi që vetëm ka përfundue. Por, ajo që më shqetësoi te ky Raport Financiar tetor-dhjetor, i nderuar drejtor, nuk e di pse nuk figurojnë shpenzimet e investimeve kapitale. Ndërsa te Raporti Vjetor Financiar, natyrisht, e ke në rregull, mirëpo te qeky raport financiar tetor-dhjetor nuk i kam pa. Mos jam gabim, apo? Drejtor, në rregull jam unë, po të kuptoj plotësisht ty, por unë nuk e di çka mendojsh ti. Unë e di që Raporti Financiar duhet me qenë i kompletuar dhe duhet me e ditë në tetor-dhjetor çka ka ndodhë. Çka ke pague ti edhe çfarë projekte janë përfundue gjatë këtyre tre muajve. Se unë e di që në fund, në Raportin Financiar ti i ke identifikue të gjitha projektet, por ato i përkasin komplet vitit 2024. Ndërsa, te kjo është tremujori i fundit, TM 4, dhe këtu nuk pashë unë asgjë çka ka ndodhë, send nuk di unë çka keni pague edhe çfarë projekte janë përfundue këta tre muajt. Kjo është një mangësi e juaja, ndoshta e ke bo pa qëllim, por kjo nuk është në rregull. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? 13 vota pro, 13 kundër.

Edhe kësaj radhe, votoj pro kësaj pike. Atëherë fillojmë te pika e katërt: Raporti Vjetor Financiar për vitin 2024.

Shpetim Hajredini: Nuk dua tash të hyj dhe të diskutoj për shpenzimet që kanë ndodhë gjatë vitit, edhe kodet absolutisht nuk po dua t'i diskutoj. Deshta të dal direkt tek një çështje që më bëri përshtypje shumë, këtu i keni emrat e projekteve. I nderuar drejtor, emrat e projekteve dhe shpenzimet gjatë këtij viti 2024. Po shpresoj shumë që këtë të cilën unë e kam identifikuar të jetë një lëshim, pasi që nuk është në rregull nëse e keni bërë qëllimisht një gjë të tillë. E para, shumë prej emrave të projekteve, beso, unë s'po muj as me i kuptue as çka kanë pas të bëjnë këta emra. 51226 – Kodi Pu.Mu.Mb.Rr.Kub, çka po di çka ka ndodhë këtu, në fshatin Xërxe, nashta ata xërxjanët e dinë çka ka ndodhë, por unë absolutisht këto s'po muj me i kuptue se çfarë pune është krye këtu. Tjetra çka më ka bo përshtypje është që, pothuajse 98%, buxheti i cili është planifikuar edhe është shpenzuar i tëri, në të gjitha projektet. Ishalla do Allahi këto që qenkan krye, këto projekte në Opojë, i kanë meritue gjithë këto pare. Si janë planifikue ashtu edhe i keni shpenzue, ishalla janë punimet kështu si i keni pague. Dhashtë Zoti e ia ka vlejti kjo shumë që është dhënë për ato kompani të cilat i kanë krye këto punime. Por, unë nuk besoj vallahe që të gjitha kompanitë që i kryejnë punimet, ti kryejnë 100% sa të marrin pagesën edhe 100%. Por, aty s'po muj edhe shumë me qenë i saktë, i sigurt me, thënë që nuk e kryen askush. I nderuar drejtor, kodi 54866 ka të bëjë me fshatin Kuk, besoj a ka sqarue pak Resuli. Këtu, a keni bo ndonjë lëshim që e keni fut prapë këtu në listë të projekteve, edhe buxhetin e keni të planifikuar, normal, por edhe tek shpenzimet e keni bart njëjtë. Gjë që nuk besoj që është mirë, se ju e dini vetë pse nuk është dashtë me u bo një barjete e tillë, sidomos tek shpenzimi. Pasi që shpenzim për këtë projekt nuk ka pasur edhe nuk po due me hy ma shumë në detaje, por besoj që ti do të ma japësh një sqarim edhe jemi pastaj të qartë. Të hyrat vetanake prapë i shikova, e pashë që prapë tatimi pak na kish ra bajagi. Na e kemi ulë pak, e di që ke me ma dhënë përgjigje e njëjtë, ke me thënë që na e kena votue vetë dhe për atë edhe të hyrat janë më të ulëta, apo nuk po e di a është ky shkaku kryesor apo jo. Apo qytetarët diçka nuk janë kah na paguajnë, siç na paguan në fillim. Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Përsëritet për të gjithë! Urime për një fushatë të suksesshme, urime dhe për fituesit. Ka qenë një fushatë e qetë, tash t'i kthehem punës së përditshme. Po të përgjigjem ty, Shpetim. Për investimet kapitale nuk është i vetmi projekt. Ju e dini që për muajin 11 dhe 12 mezi kemi arrit që në bashkëpunim me Qeverinë dhe me Thesarin të bëjmë një rishikim, edhe për paga dhe mëditje, për vetë faktin se përmbaruesi na ka marrë të gjitha mjetet dhe ato projekte të cilat

kanë qenë mjetet e pazotuara dhe të lira, edhe ky projekt nuk ka qenë i kontraktuar, të gjitha ato mjete janë marrë për investime kapitale, nga ky destinim, dhe përpos këtyre e ke në raport. Përveç që janë marrë nga investimet kapitale, nuk është i vetmi projekt, ke një varg projektesh, por si shpenzim i tillë që ka qenë i paraparë, kur e bëjmë barazimin me investimet kapitale, na përputhen të gjitha mjetet të cilat na i ka marrë, për arsye se 95% të buxheti, ti e dish mirë, që është i harxhuar në total. Tash, nga investimet kapitale kemi të marrme, nga mallrat dhe shërbimet kemi të marrme, ju e dini se na ka marrë edhe të shpenzimet komunale që janë shpenzime fikse. Ka arrit deri aty situata me përmbaruesin. Prandaj, këto janë të tilla si janë. Nuk kemi mund t'i eliminojmë, por kemi shkruar që t'i dimë prej ku na janë marrë. Ne zotohemi që gjatë këtij viti, në qoftë se bëjmë mjete, ne do të mundohemi ta kryejmë atë projekt i cili nuk ka qenë i kontraktuar, nuk ka qenë i publikuar, nuk ka qenë i zotuar. Sa u përket të hyrave vetanake, me vendimin e ri për tatimin në pronë, ju e dini se nga 15% të cilat kanë qenë të falura nga qeveria për me e arsyetue vendimin që e ka rrit nëpër zona të ndryshme, ka shkue për objekte ndërtimore e ka ulë në 30 mijë euro. Automatikisht, ulja për objekte në 30 mijë euro ka reflektue në rënien e tatimit në pronë. Gjithashtu, i kemi edhe vendime të cilat i kemi marrë si Kuvend Komunal, kemi ulë zonën, në radhë të dytë kemi ulë edhe përqindjen dhe këto kanë reflektuar. Mirëpo, në përgjithësi ne kemi rritje 13% të të hyrave vetanake. Megjithë këto ulje, kemi rritje. Janë rritje esenciale nga objektet të dhëna me qira dhe kemi disa rritje tjera që ju i keni parë aty. Unë mendoj se në përgjithësi, si bilanc përfundimtar, jemi pozitivisht edhe me të hyrat vetanake.

Shpetim Hajredini: I nderuar drejtor, ti fort mirë e din që unë i kuptoj këto gjëra mirë. Tjetra, una flas specifikisht për fshatin tim, e dish gjithmonë. Bashkëfshatarët nuk mujn me e dit çka ka bo Qamil Kolloni ose Shpetim Hajredini me këtë projekt. Pse po e them këtë? Se në momentin që e shoh unë se janë planifikuar 20 mijë euro, dhe t'i ma qet në kolonën tjetër janë shpenzuar 20 mijë për këtë projekt, emri i të njëjtit projekt, unë dyshoj. Këtu ishte pyetja, unë deshta me e sqarue çka ka ndodhë me këtë projekt. Ti ma dhaje sqarimin tënd, shpresoj kur të na biesh raportin tjetër financiar, duhet me e ndryshue, me tregue çka ka ndodhë plotësisht me këtë. Nëse nuk e bëni një gjë të tillë, atëherë shohim format tjetër. Edhe tjetra, te tatimi në pronë, una ta bëra pak në formë shakaje, e thashë në formë krahasimore vit në vit, nuk e pata qëllimin për ma thellë diçka tjetër. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën rreth kësaj pikës? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro Raportit Vjetor Financiar për vitin 2024? A ka

kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 13 kundër, prapë unë votoj pro kësaj pike. Atëherë, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Nëse nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e gjashtë: Raporti i Punës i KKSBB-së për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e shtatë, pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Sot, qysh në fillim u pa se e keni kap si keq, kryesuese. Në seancën e fundit propozimin e Munirit e kemi votue pesë herë, ndërsa sot nuk i jepet fjala Dritonit për sqarim. Po nejse, kaloi ajo, kam qef mos me u përsërit. Qysh në fillim e kërkoja që të jetë në pikë të rendit të ditës problemi i mediave. Po shihet qartë se i keni kap disa media, sidomos TV Opojën. Radio Sharri, 95% nashta e ka transmetimin e fundit, ndërsa TV Opoja pjesën e dytë nuk e ka në rrjete sociale. Më e keqja është që ka qenë live, dhe unë kërkoj nga kryetari që të jeni transparent, a keni kontrata me këto radio-televizionet lokale? T'i bëni transparente, se gojën plot e keni transparencë, t'i bëni transparente këto kontrata. Edhe kërkoj nga ju që të mos i detyroni – se me siguri dikush i ka detyrue këta për me e fshi postimin. Publikisht i bëj thirrje TV Opojës, për hir të qytetarëve, delegatëve dhe transparencës, të kthehet pjesa e dytë e seancës së fundit, të kthehet në ritransmetim, ta shohin qytetarët. Unë s'po due me e kqyrë te Radio Sharri, po due me e pa te TV Opoja bisedat e mia, fjalimet e mia, s'janë kërkund. Qytetarët ankohen, kjo është e dijjshme që po i kapni këto mediat. Po më vjen shumë keq, edhe është mirë herave tjera mos me ndodhë kjo. Edhe e dytë, po më vjen turp me e diskutue mo me kryetarin, se u bë e tepërt, rreth ndriçimit në fshatin Rrenc. Kryetar, më ke akuzue se në dy lagje me qëllim unë e kam ndërpre projektin mos me shkue. Aty dy rrugë kanë qenë rrugë kryesore, njëra është për Kapre, tjetra është për te varrezat poshtë. Fjalimin e fundit, përgjigjen e fundit që e kam marrë nga ti në seancë – e kam ngue në media – ka qenë shumë e ulët. Nuk është me rëndësi. Unë po due me tregue që ju – jo ne, po ju bëni ndasina. Para dy ditëve, shkaku i votave, në fshatin Rrenc ka ndodhë shkaku i votave, qato dritat ku e keni krye projektin i keni dhezë, nja dy-tri a pesë drita në do lagje ku votohet, ndërsa nëpër lagje tjera e keni lënë Rrencin në terr. Le ta sheh edhe TV Opoja edhe Radio Sharri. Kjo është e ulët, edhe ju kam thënë që kjo është e ulët, se qytetarët e fshatit Rrenc LDK-në

e kanë kuptue. Ju kallxuan dje, që kush manipulom me ndriçimin, kush manipulon me tenderat, keni mbet me një grusht vota. Nuk kalojnë në Rrenc këto të juajat, se veç një lagje ku i keni do votues, i keni çue nja tri drita, qendrën e fshatit Rrenc, aty ku votohet VV dhe PDK, aty'ska drita. Edhe po due me e ditë, pa u krye projekti, kush i dhezë ato drita, a keni dikënd në fshat që i prek ato dritat? Po më vjen keq, se në vjeshtë ke me mbet me 30 vota, po due me të kursye pak. Mos kryetar, se është e ulët. Dy ditë para zgjedhjeve i keni bo, edhe i morët veç 50 vota. Në qoftë se vazhdoni qeshtu, me 30 keni me mbet, publikisht po ju them. Bare nja 70-80 mbërrini në vjeshtë. Është e ulët kjo, mos më akuzoni mu. Qytetarët e fshatit e dinë kush është Artani, e dinë kush është LDK-ja, e dinë kush është kryetari, e dinë kush është drejtori. Jau kanë kallxue vendin edhe di t'jua kallxojnë vendin edhe në tetor. Të kam thënë në fillim, qaj drejtori që po të keshet ka ardhë për një mandat, ju ka ardhë për një mandat, po shkoni kismet, sot një vit jeni në opozitë.

Uran Halimi: Të nderum kolegë delegatë, media dhe të gjithë pjesëmarrësit këtu që jeni në Kuvend. Po e filloj me zgjedhjet që sapo i kryem ne. Faleminderit për disa që ma uruan qatje kah fundi, fitoren e LVV-së. Gjatë proceseve zgjedhore mirë që kaluam pa ekcese dhe e kaluam një process goxha të mirë të fushatës. Ajo që më duhet me e theksue është që individë ose subjekte të caktume politike kanë bo goxha presion në këtë fushatë e kanë përdor shumë mekanizma të ndryshëm, në njëfarë mënyre e kanë terrorizue edhe votuesin. Mirëpo, kur është në pyetje LVV-ja, ju e keni pa që qytetari as nuk shitet, as nuk kërcënohet, as nuk shantazhohet, edhe pse keni shfrytëzue gjithçka që e keni pas në dorë, duke u nis edhe prej pozitave që jau ka dhënë populli. Megjithëse dolët keq, prej qeverisjes komunale, dikur në vendin e parë, shkuet në vendin e tretë. Sidoqoftë, edhe në zgjedhjet e 2021-tës ne jemi konë fitues të zgjedhjeve. Unë falënderoj publikisht qytetarët që na kanë besue edhe na kanë mbajt njëjtë edhe pas katër viteve fitues të zgjedhjeve të përgjithshme. Pjesa tjetër, që folëm edhe në KPF, ishte puna e mediave, mostransparenca e seancave, mospublikimi i pjesë së dytë të seancës. Edhe pse unë nuk kam qenë në atë pjesën e dytë, znj.kryesuese, nuk kam mund me e gjet kërkund në media pjesën e dytë, ose vazhdimin e seancës, që jeni kthye pas pauzës. Po mendoj edhe besoj që i keni terrorizue edhe mediat, në njëfarë mënyre, jeni mundue me e kap çdo cep – kur ju thashë atëherë në foltore – e kjo nuk është aspak demokratike, e aspak nuk i ndihmon demokracisë. Unë kërkoj nga ju, znj.kryesuese, që për këto mediat të cilat e kanë fshi pjesën e dytë të seancës, duhet me i largue prej këtu krejt, edhe me e hap një tender për një media sa më transparente, ose të paktën, s'ka nevojë me i largue, por jo me i pague prej këtij Kuvendi. Ne i paguajmë, znj.kryesuese, për me e

bo publike seancën, për me e çue te qytetari punën e Kuvendit. Se ne të Raporti i Kuvendit votuam pro që ka punue ky Kuvend, e qytetarët s'kanë ku me e pa çka kemi punue na, përderisa po fshihen ato incizimet e seancave. Kisha lut që të mos keqpërdoret paraja publike, me pague media edhe me kërcënue media, me fshi seanca, se kjo është hiç demokratike, edhe kur në vitin 2025, në vitin kur ne mendojmë që ka shumë demokraci në vendin tonë. I bjen që, jo neve si delegatë, por e kemi për obligim që qytetarëve të kësaj Komune t'i raportoni me nder edhe me transparencë. Faleminderit shumë!

Driton Ademi: Unë dashta me u ndëlidhë pak te disa projekte, që parëz edhe drejtori nuk i përmendi, megjithëse Shpetimi ia tha, po nuk deshta me dalë mas drejtorit. Drejtor, shumë mirë ti e dish që i ke parapa kishe të pagume, i ke krye projektet – po foli veç për fshatin Bresanë – kubëzat i ke të papërfundume tama, edhe ato që i ke përfundue, i ke përfundue ma shumë nëpër rrugica ose nëpër oborre. E dyta, parkun në qendër e ke pa përfundue, a paret jau u ke lëshue. E treta, me kryetarin e kam. Kryetar, në seancën e kaluar edhe pse kam qenë këtu në foltore, me ke thënë ec të të çoj te oftamologi, se s'po shihke mirë po as s'konge mirë. Për mashat e borës te salla e sportit. Po më vjen palidhje me i thënë dikujt me i marrë një palë syza, a me i marrë unë ato syzat, a me i marrë ti ato syzat. E tash mirë kishe bo që kishe shkue e i kishe vu mashat, se vetë e ke pa që më ke akuzue, me ke thënë po duhet me të çue te oftamologu, se e ke falas në QKMF. Po kishe shkue e i kishe vu. Edhe shpia malore. Domethënë, qeto projektet të cilat ti i ke pas – po foli veç për në Bresanë – asnjëri projekt nuk ka përfundue deri në fund. Unë po them publikisht këtu, le të vjen policia, hetuesia, kush të do le të vjen e le t'i kontrollon nëse qeto projekte janë krye. Asnjë nuk është krye në mënyrë të rregullt. A paret, buxheti, i janë lëshue secilës cent më cent, sa ka qenë planifikimi, thuajse gati cent më cent janë lëshue. Mu qekjo po më vjen turp që jam i Bresanës, që është kryetari i Bresanës, edhe qeto projekte asnjë në mënyrë të rregullt. Unë nuk e di ky Kuvend edhe këto gjykata a janë duke u marrë me këto projekte, a është duke u marrë dikush, kush jau lëshon këto paret. Është mirë dikish me marrë me këto projekte. Edhe disa projekte që i pashe aty sot, a i keni pru me qëllim, a i keni pru pa qëllim, emrat e fshatrave në fund nuk jau keni shkruar. Kanalizimi, kubëzim, në fund fshatin nuk ia keni shkruar. Lë që s'na keni pru kopje fizike, lë që edhe po manipuloni nëpër emaila, se s'jau keni shkruar fshatrat në fund. Qekjo është për turp me ju ardhë. Se masnej dalish e më thuesh drejtor, turp ty me të ardhë, po për turp ju, kape kqyre emailin, si mos ta kie, unë t'i jap qe kopjet fizike i kam, mundish me i pa. Qeto projekte, sidomos po foli për Bresanë, nuk po di për fshatrat tjerë, veç për Bresanë, asnjëri projekt nuk është i

përfunduar. A paret për secilin projekt janë të lëshuara thuajse gati cent më cent. Le ta dinë qytetarët që këtu, veç sa me thënë me i çue do bagera, do kubëza, nuk bëhet kështu, derisa nuk kryhet projekti. Po për qeto dikush ka me marrë përgjegjësi. Sa të jam unë qetu, nuk kam me e lonë rahat, ka me marrë përgjegjësi, sidmos për Bresanë, po edhe në fshatrat tjerë, ku kam mundësi me i pa që ju nuk i keni krye punimet deri në fund, atëherë dikush ka me marrë përgjegjësi.

Nedžmidin Sejdilar: Unë nuk kam dashur të përgjigjem, por ju më dhatë mundësinë të përgjigjem, duke pasur parasysh se më kritikoni në faqen e komunës për lajthimin e opinionit. Të gjithë jeni në dijeni të ngjarjeve të fundit në seancën e kaluar, kur me sugjerim të kolegut tim Jonuzi, u kërkua që posti i zëvendës drejtorit të përfshihet në Statutin e QKMF-së, që t'u takojë komuniteteve joshumicë. Jeni në dijeni të faktit dhe sjelljes arrogante të kryesues se kuvendit, e cila me dhunë ia fiku mikrofonin Jonuzit kur donte të vinte në dukje gabimet procedurale dhe parregullsitë, ne në emër të partisë sime dhe të JGP-së, kolegu Kurt, protestuam në mënyrë demonstrative dhe kolegu Jonuzi u larguam nga seanca. Pas kësaj keni thënë se Sejdilar ka manipuluar inxhizime dhe e ka montuar. E gjithë kjo në ueb faqen e komunës së Dragasit. Dhe sa i përket manipulime me imazhe grafike, mbani mend atë foto kur vizatuat lloj-lloj gjërash mbi pantallonat e mia. Kur vjen puna te manipulime, ju jeni kampionë dhe askush nuk mund t'ju bëjë ballë. Është detyrimi im që të informoj rregullisht publikun për gjërat që ndodhin këtu. Dhe se publiku e di se kush i përfaqëson këtu dhe si. Në kuvendin e kaluar, kolegu Kurt, nuk e kuptova pse kolegja juaj mbeti në sallë, por kolegja juaj nuk është kolege juaj, sepse ajo përfaqëson interesat e saj personale. Vajza e saj u emërua zëvendës drejtoreshë e qendrës shëndetësore dhe kjo tradhti duhej paguar. Ju kërkoi falje edhe një herë që ju desh të paraqiteshit kështu në seancën e kaluar, keni përkrahur propozimin e kolegut Jonuzi dhe keni reaguar ashtu si duhet një njeri i nderuar dhe i ndershtëm. Të nderuar qytetarë, duhet ta dini se në këtë kuvend ka larmi tregtie. Një nga kolegët tuaj duhet të tradhtojë të gjitha interesat tuaja për hir të një pune ose për t'u kujdesur për vajzën e saj. Kjo ka ndodhur në komunën tonë. Zonja kryesuese dhe zoti kryetar, ju keni obligim t'i kërkonit falje goranëve dhe të mos më paraqisni këtu si përbindësh. E patë si reagoi populli im, jam i kënaqur dhe krenar për popullin tim. Populli ju ka treguar se ku e keni vendin dhe do t'ju tregojë në zgjedhjet e ardhshme, duke ju futur në opozitë. Sepse ju dhe administrata juaj jeni krejtësisht të dëmshëm për popullin tim. Këtë e deklaroj me përgjegjësi nga kjo foltore dhe e di që populli im do të marrë vendimin e duhur në zgjedhjet e ardhshme. Ndër të tjera, ne pamë rezultatet e këtyre zgjedhjeve parlamentare, se populli dhe bashkëqytetarët e mi në Opoje kanë filluar të zgjohen dhe ju kanë treguar se ku e

keni vendin. Ju zbritët në vendin e tretë. Nuk e di se si prisni të qëndroni në pushtet në zgjedhjet e ardhshme dhe në vend që t'i kërkonit falje goranëve për mënyrën se si keni reaguar si vizualisht ashtu edhe fizikisht, po mashtroni popullin, pasi ne duam t'i prishim marrëdhëniet ndëretnike në komunën e Dragashit. Nuk mund ta prishim, edhe pse ju po e bëni me mjeshtëri me përpjekjet tuaja. Ne kemi kërkuar vetëm që të mos na jepni asgjë që na takon. Ndryshimi në Statut është se ju po përpiqeni të paraqiteni si një njeri që jep me kënaqësi komuniteteve dhe ne kërkuam që në statut të përfshihet edhe posti i zëvendës drejtorit të qendrës shëndetësore. Se ligjërisht na takon neve. Ju nuk e keni lejuar këtë, keni shkelur procedurat e votimit dhe keni shkelur të gjitha normat dhe keni treguar se nuk jeni konsekuent për t'ju mbështetur në Gorë. Të nderuar qytetarë, kemi shtatë apo tetë muaj deri në zgjedhjet lokale, mendoni mirë nëse do ta mbështesni këtë qeveri, nuk keni pse të më mbështesni mua, as karrigen ku ulem, por mendoni të mos i ktheni në pushtet ata që mbajnë pushtetin sot.

Jetmir Ajdini: Së pari falënderoj qytetarët e Dragashit që për këtë proces zgjedhor e kanë treguar një pjekuri të lartë, e kanë bërë një proces fer e demokratik zgjedhor. I falënderoj posaqërisht për mbështetjen e madhe që ia dhanë LVV-së, e na nxorën fitues të këtyre zgjedhjeve. Mu më vjen keq që kjo seancë mbahet një ditë pas një fushate njëmuajore zgjedhore, po kjo tregon për frikën që e ka pushteti për me u përballë me qytetarët, me u përballë me të vërtetat këtu në Kuvend, por këto nuk e ndryshojnë rezultatin. Qytetari jau tregon vendin edhe qytetari ju tregon se ju jeni veç për opozitë. E, ju ka rendit të tretët. Edhe përkundër shantazheve, edhe përkundër krejt arsenalit komunal që e keni pas në dispozicion, edhe përkundër krejt financave të devollëve, qytetari ju ka rendit të tretët. Qytetari i Dragashit as nuk shitet, as nuk blihet. Qytetari i Dragashit vendos vetë, nuk bën të shantazhohet, as nuk bën të tentohet me u ble qytetari i Dragashit. Unë kisha pas qef që devollët me ardhë me investue këtu, me bo ndonjë fabrikë, e jo me ardhë me investue në blerje të votave. Këto janë rezultat i mospunës suaj për katër vjet. Edhe për atë qytetari jau ka tregue vendin edhe ju ka rendit të tretët. Kështu që, për qytetarin duhet punë, qytetarët duhet të lihen të vendosin vetë, kë do ta votojë edhe kë do ta zgjedhë, e jo t'i përdorni gjithë ato mënyra që i keni përdorë. Merrni shembull se si bëhet një fushatë zgjedhore fer, pastër edhe pa asnjë shantazh, pa asnjë kërcënim, pa kurgjo tjetër që e keni pas ju në dispozicion. Kështu që, unë i falënderoj edhe një herë qytetarët, për krejt këtë proces zgjedhor fer e demokratik që e kanë tregue, edhe i falënderoj që s'janë bo pjesë e këtyre shantazheve që këta i kanë provue me i bo. Kështu që, faleminderit publikisht qytetarëve të Dragashit.

Agron Gashi: Atëherë, ju përshëndes të pranishëm! Kolega më parë foli lidhur me procesin zgjedhor. Edhe unë e përshëndes nga këtu, se ishte një proces shumë demokratik, që ndoshta do të vlerësohet edhe nga faktorët ndërkombëtarë. Por, ajo që ia dedikuar qeverisjes komunale, paksa duhet të bëjmë një vlerësim më adekuat, ngase qeverisja aktuale trevjeçare e z.Xheladini, ka dëshmuar si një qeverisje e mirë. Qoftë nga vlerësimet nga qendra e Prishtinës, por qoftë edhe nga këta, nga performanca e punës që ka treguar, ka marrur një grant qeveritar për tri vite radhazi, për qeverisje të mirë që investimet kapitale, dhe lidhur me transparencën qytetare ka treguar suksese të mira. Këto janë zgjedhje nacionale, të nivelit qendror, dallojnë me individë dhe me qeveri komunale, që është vlerësuar që ka hy në kuadër të qyteteve të Kosovës, si një kryetar për qeverisje të mirë. Tash, tetori do të vijë, zgjedhjet do të mbahen, atëherë do të shihni rezultatet se si do të variojnë. Tjetërçka desha të foli lidhur me pikën eventuale, kryetar. Kam një shqetësim: Nga rruga regjionale Zhur Dragash, vitin e kaluar si shpejt janë vendosur tabelat e komunikacionit rrugor, të cilat, ajo kompani e cila ka qenë dhe i ka vendosur, a i ka vendosur mirë apo, për shkak të reshjeve atmosferike që ka pasur dhjetori dhe janari, kam parë gjatë rrugës se kemi përmbysje bukur shumë të shenjave të komunikacionit, e ato shenja janë jetëra njerëzish. Tashti po kërkoj që juve si ekzekutiv, juve si kryetar, kompania e cila i ka vendosur, ndoshta edhe ka pasur lëshime që nuk i ka vendosur mirë, dhe është numër i konsiderueshëm i këtyre tabelave të cilat vërtet është shqetësues për qytetarin, sepse me ato orientohen dhe të merren masa, sa më shpejt të bëhet rregullimi i tyre, riparimi i tyre, dhe të shpëtojmë jetë. Kaq pata. Faleminderit shumë!

Mehmet Spahiu: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesuese! Të nderuar këshilltare dhe këshilltarë! Sot nuk e kam pasur ndër mend ta marr fjalën, ngase u thanë shumë gjëra. Por, ajo që më nxiti më tepër janë sulmet që i bëhen kryetarit në këtë mbledhje dhe në disa mbledhje të mëhershme. Kryetar, u bë një interkomunikim me ju, me i tregue Nexhmidin Sejdlarit fillimisht - se ai po thirret në emër të popullit – ai nuk duhet të harrojë që ju, edhe unë bashkë me ju, nga viti '91 nga stërgjyshërit e tij kemi qenë të larguar nga puna. Për dhjetë vite kemi qendruar pa punë. Përkundër asaj - edhe 14 më pas kemi qendruar pa punë – kemi gjetur forcë, i kemi tejkaluar të gjitha këto padrejtësitë që janë bërë në kurriz tëndin. Dhe, jeni ndër kryetarët që më së tepërmi jeni përkushtuar për këtë Komunë. Këtë e dinë shumë mirë të gjithë qytetarët tanë, aq më tepër qytetarët e Gorës, në emër të të cilëve thirret Nexhmidin Sejdlari, i cili i ka vetëm 200 vota. Tjerave herë nuk duhet të lejohet që ai të flet në emër të popullit të Gorës, se ai nuk përfaqëson popullin e Gorës. Njëkohësisht, edhe zv/kryesuesi ka bërë disa veprime jo të pëlqyeshme në adresë të kryesueses,

për çka duhet t'i kërkojë falje. Unë kërkoj që këta delegatë që përfaqësojnë komunitetin pakicë, po edhe këta tjerët për të cilët kam edhe disa fjalë, duhet së paku të jenë në nivel të kulturës që e ka populli të cilin ata e përfaqësojnë. Ju të nderuar delegatë të VV-së, po ju them se, nëse ndonjë qytetar ka pasur të drejtë të votojë për VV-në, qytetarët e Komunës së Dragashit kanë pas më së paku të drejtë për të votuar. Ngase, shumë më tepër ka pas të drejtë dhe kanë të drejtë të votojnë qytetarët e Pakishtës dhe Zapotit, tek të cilët ka investuar 2 milionë e 700 mijë euro, ndërkaq për qytetarët e Komunës së Dragashit nuk e ka parë të arsyeshme as t'ua kompenzojë dëmet të shkaktuara nga vërshimet e ndodhura vitin e kaluar. Më vjen keq që ju përfaqësoni një parti, e thirrëni që jeni të parët, por ju do ta shihni edhe në tetor kush është Lidhja Demokratike, shumë shpejt keni me e pa, edhe keni me u bind që Lidhja Demokratike është parti që ka 35 vite përvojë. Ju jeni adoleshentë në krahasim me atë që e përfaqëson LDK. Prandaj, tjera herë ju lutem që të jeni shumë të kujdesshëm. Kryetar, të mos biesh pre e këtyre shprehjeve, ngase ju keni dinjitetin tuaj, keni përkrahjen e popullatës, si në trevën e Gorës, ashtu edhe në trevën e Opojës. Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Zoti Spahiu, unë përfaqësoj ata qytetarë që kanë votuar aq sa unë të ulem në atë karrige atje. Aq sa ishte e nevojshme. Këta njerëz janë njerëzit e mi. Njerëzit e mi janë edhe ata që nuk më kanë votuar. Ne nuk mund ta ndajmë popullin në vija partiake, populli ndahet sipas përkatësisë etnike dhe kombëtare. E di që dëshironi ta minimizoni, por sado të vështirë të ishin, ata ishin luanë të vërtetë që rrezikuan barkun e tyre dhe unë kurrë nuk do ta tradhtoj atë besim. Jemi në prag të zgjedhjeve të reja lokale, do të presim se kush do të fitojë dhe si do të kalojë, populli është në gjendje të vlerësojë situatën, të shohë kush i përfaqëson dhe si, absolutisht nuk kam asnjë problem, madje edhe nëse nuk fitoj asnjë votë, jam krejtësisht i parëndësishëm në këtë kuvend. Është e rëndësishme të respektohet vullneti i popullit. Dhe është e rëndësishme që nuk i kam shitur ata 250 votues këtu. Edhe pse kishim oferta të ndryshme për shitje. Unë po flas për shitjen e votuesve. Nuk e di pse ju ka prekur kaq shumë kur në seancën e fundit ka ndodhur shitja e votuesve nga delegatët në Kuvend. Vajza e saj u emërua zëvendësdrejtore me 37 ditë eksperience. Problemi u shfaq në kuvendin e kaluar sepse ne kemi kërkuar atë që na takon dhe jo që ju të na e jepni. Kjo pasqyron barazinë e të gjithë qytetarëve. Kryetari vendos nëse do t'u japë komuniteteve joshumicë ndonjë pozitë dhe ne kemi dashur ta përfshijmë atë në statut dhe të na takojë neve. Aty lindi konflikti. Kolegja ime qëndroi në sallë për t'ju mbështetur për hir te emërimit e vajzës së saj nëndrejtoreshë të qendrës shëndetësore, kjo është e qartë për të gjithë. Kjo nuk mund

të mohohet, është evidente, 37 vite shërbim dhe tani ajo është zv.drejtoreshë. Dhe çfarë do të bëjnë fëmijët e tjerë që studiojnë në universitete dhe ndjekin shkollën nëse nuk kanë dikë nga familja e tyre në kuvend? Studentët që mbarojnë shkollën dhe nuk kanë asnjë deputet apo politikë që t'i shtyjë në një pozicion për të bërë punën për të cilën kanë shkuar në shkollë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pasi që z.Spahiu nuk përmendi emra të përveçëm, e lus shefin e Grupit të VV-së që ta marrë fjalën, ose merrni vesh njëri prej jush.

Jetmir Ajdini: z.Spahiu, unë nuk mundi me e pas as moshën, as përvojën tënde në politikë, për arsye se jam i ri edhe nuk e kam moshën, edhe nuk kam mund edhe me e pas moshën. Respekt për moshën, respekt për kontributin që e keni dhënë, por këta adoleshentë janë këta që ju kanë pru juve në pushtet, qeverisjen komunale. E dini shumë mirë punën e koalicionit qysh e keni pas, edhe kush ju ka pru në pushtet juve, pas sa viteve. Edhe ju jeni ata që ia keni kthye shpinën edhe e keni tradhtue këtë koalicion. Ju jeni ata që i thoni qytetarit të Dragashit se keni pak të drejtë me e votue LVV-në. Nuk e përcakton ti se kënd e voton qytetari i Dragashit. Po më vjen keq, po nuk e përcakton ti se kënd e zgjedh qytetari i Dragashit. Mendimi yt është ai, por ti s'un e përcakton kënd e voton. A po don me të kallxue çka ka bo për Dragash? Qe po fillojmë: Rruga Zhur – Dragash – Brod është komplet financim i Qeverisë. Kush e ka financue? Kush i ka financue rrugët e bjeshkës që i ka ndërtue kryetari? Kush e ka financue rrugën Kapre-Rrenc? Të kujna janë ato pare? Kush i ka dhënë ato pare? Nuk ka ndonjë qeveri që ka bo ma shumë për Dragashin se ajo e LVV-së. Nuk ka! Edhe ka me vazhdue me pas të mira për Dragashin, se prapë ka me qenë në qeveri kryeministër Albin Kurti. Edhe qytetarët e Dragashit kanë me ia pa hajrin prapë edhe kanë me pas edhe shumë më shumë të mira. Ai është mendimi yt, ama qytetarët e kanë kallxue me votë. Mu më vjen keq, ju nuk jeni fer, ju nuk jeni në gjendje me pranue humbjen. Po keni humb, mu më vjen keq që keni humb, s'kemi çka ju bjëmë. Qytetari ka vendos, qytetari ju ka çue në vend të tretë. Prej qeverisjes komunale, ku jeni në opozitë, ju ka çue në vend të tretë. Ku je në vend të parë? Ti fole për zgjedhje komunale, ti fole për zgjedhje nacionale edhe thaje qytetari i Dragashit ka më pak të drejtë me e votue LVV-në. Ta ka tregue vendin me votë qytetari i Dragashit. Respekt të thashë për moshën, për përvojën politike – unë nuk muj me e pas përvojën tënde politike, se nuk e kam moshën – por këta adoleshentë qytetari i Dragashit ka vendos me i votue. Kështu që kjo veç duhet me u urue, prej secilit prej juve, se është proces demokratik që ka kalue. Nuk ka kurgjo të keqe, dikush ka me dalë në vend të parë, dikush në të dytin, e dikush në të tretin. Kështu që, duhet me u pajtue me fatin. Faleminderit shumë!

Nexhat Selaj: Faleminderit! Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesuese, kolegë asambleistë, media dhe ju të tjerë! Nuk po më duket mirë që këto zënkat partiake po shprehen tash. Ne jemi në pikën eventuale e cila duhet të diskutohet krejt diçka tjetër. Por, pavarësisht, ne si të opozitës nuk po them se po shikojmë seri me ju se çfarë bëni, por nuk po na vjen mirë. Këtë e kemi tregue edhe në fillimi kur ju keni lidhë koalicionin, edhe ne e kemi ditë që ky koalicion nuk do të jetë jetëgjatë. Pavarësisht nga ajo, ka qenë politika juaj të cilën ju e keni shfrytëzuar. M'u tekën fjalët e Uranit në fillim, kur thojke do të jetë qeveri stabile, do të investojmë, e tash replikon, me të drejtë apo pa të drejtë, e din ai. Unë nuk do të ndalem te kjo, veç nuk po më vjen mirë para qytetarëve, që të na shohin qytetarët këtu zënkat. Unë do të futem drejt në investimet të cilat i takojnë fshatit nga vij unë. Edhe një pyetje do ta kem për drejtorin e Financave. Kryetar, në vitin 2022-2023 për fshatin Zym janë ndarë 25 mijë euro. Për vitin 2023-2024 janë ndarë 30 mijë euro. Këto bëjnë 55 mijë euro. Të investuara në këtë fshat kemi urën – 8 mijë euro – e cila ka mbet në gjysmë, dhe kemi një trasim të rrugës me gurë që ka kushtue në vlerë deri në 10 mijë euro. Nga 55 mijë euro, kemi të investuara 18 mijë euro. Thatë që përmbaruesi ka marrë një pjesë të të hollave, por kisha pas dëshirë që nga ju apo nga drejtori i Financave të dalë e të arsyetojë për këto para. Edhe do ta përmendi një fjalë të vjetër popullore, thuhet se aty ku është peri i hollë aty po shkon e po këputet. Po ku përmbaruesi po i merr paratë. Aq pak të ndara për fshatin Zym edhe ato merre të gjitha. Një pyetje e dytë shkon për drejtorin e Financave. Drejtor, për periudhën 2024, a mund të jesh pak transparent dhe të dalesh këtu në foltore të na tregosh se nga sasia e përgjithshme e kubëzimeve publike, sa keni bë, sa u takojnë atyre private? Sepse kemi shumë replika nga popullata çdokund, se thuhet që shtrohen 50 metër rrugë publike, e shfrytëzohen 200 metër katrorë rrugë private. Nëse ju keni ndonjë statistikë nga e përgjithshmja për vitin 2024, kishte me qenë mirë që për hir të transparencës të dilni këtu dhe të njoftoni se nga sa kilometër apo metër kub janë shtruar rrugë publike, sa u takojnë atyre private. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Z.Uran, unë nuk e shkeli Rregulloren e Punës, dhe parëz nuk ta dhashë me qëllim se nuk t'u përmend emri. Tash del e merre fjalën se t'u përmend emri, veç ta dish që unë i përmbahem Rregullores. Tash ti përmendja emrin Sejdlarit, kamerat le të ju përcjellin se çfarë lojëra bëni ju.

Uran Halimi: Shumë faleminderit! Ju lutem, kamera e media, më përcillni non-stop kur të hyj këtu në seancë, se qytetarët kanë qef me më pa vazhdimisht mu në media. Kjo është ma shumë se e qartë, e dini ju shumë mirë ndikimin tim politik në këtë Komunë. I nderum delegat parafolës,

thaje që jeni praktikanta, a çka na thaje, adoleshenti në politikë. Shumë keq është kur adoleshenti të bjer në këtë pozitë edhe ti me e nxjerrë atë mllëfin që e ke përbrenda. Më e keqja është që kallxohesh edhe bukëshkelës, e ne jemi ata që juve ju kemi ulë këtu ku jeni. E dinë qytetarët, për atë të kanë dënue qytetarët, se shqiptari nuk ta fal tradhtinë. Qeta adoleshentët juve ju kanë prurë qetu ku jeni, e ju e keqpërdorët atë mirësinë menjëherë pasi u ulët në ato kolltuqet që i keni qef edhe i keni ëndërrue goxha gjatë. Mirëpo nuk do t'i gëzoni shumë, se qe fundi po vjen. Keni mendue që 4 vjet janë 40, por jo. Juve ju kanë shkue shumë shpejt. Unë s'fitoj në Blaç, unë fitoj në Komunë edhe në Kosovë, i nderum. Ju fitoni në Blaç, se jeni fokusue ju në Blaç e na këndeje veç dasmën jau dhezëm. E kemi rrugën që thaje qytetarët e Pakishtës, mu më vjen mirë një qeveri që i kontribuon lidhjes së Kosovës me shtetin amë që e kemi Shqipërinë. Bash këtu nuk të ka pas hije me thënë, se shqiptarë jemi edhe na, edhe ata. E, shyqyr Zotit, veç rrugë me shqiptarë kam qef me lidhë. Tjetra, investimet, ti e dish shumë mirë që dikur i keni promovue si investime të juajat, rrugën e Rrencit, të Pllajnikut, e keni promovue si investime të juajat rrugët e bjeshkëve, rrugën e Strezimitit, e mandej keni dalë edhe keni kërkuar falje, keni thënë vallah-bilah jemi bo pishman se këto janë investime të qeverisë. Edhe qato paret e Grantit që po i marrish ti, i nderum, edhe po dalish po dalish po krenohesh këtu, janë pare të qeverisë. Edhe të babës tënd, po, edhe tëndit edhe temit. Nëse s'janë paret e babës tem, është gjaku i babës tem që e ka dhënë që ti me e gëzue këtë liri. Edhe mundësisht babën s'ke nevojë me ma përmend. Ti mu mundesh me më përmend, e te baba jem të lutem rahat rri. Nëse s'ka dhënë pare baba jem, e ka dhënë jetën për ty, që ti sot me e përmend këtu. Del këtu e më kallxo çka ke bo.

Nedžmidin Sejdlar: Zonja Kryetare, ju falënderoj për të drejtën e përgjigjes, së pari, më lejoni t'ju informoj se në parlamentarizëm ka mënyra të ndryshme për të penguar kuvendin kur Kuvendi nuk po bën gjënë e duhur. Unë mund të komunikoj me kolegun tim Uranin ose këdo tjetër në pozicionin tim si të dua. Ju nuk keni absolutisht të drejtë të komentoni sjelljen time në kuvend dhe marrëdhënien time me ta. Përderisa sillem në mënyrë të artikuluar dhe për sa kohë që nuk ndërhyj fizikisht në punën tuaj. Mund të bëj edhe shaka me të nëse nuk më intereson diskutimi në kuvend. Ju kërkoj të jeni të sjellshëm dhe të mos komentoni sjelljen time në kuvend. Është përgjegjësia juaj të drejtoni asamblenë siç duhet dhe të ruani disiplinën në asamble. Edhe unë kam të drejtë dhe askush nuk mund të ma mohojë këtë të drejtë. Derisa të qetësoni anëtarët e Partisë suaj, edhe unë do të veproj ashtu. Ky është reciprocitet.

Samidin Xheladini: Ti babën e dish kënd e ke babë, qato ta thashë unë mos janë të babës tënd, të atij që i ke vikat baba-baba. Nuk të thashë babën tënd personalisht. Babën atje që i keni vikat baba-baba-baba. Të lutem, mos shko në personale! Kërko falje publike! Të thashë mos janë paret e babës tënd, janë paret e popullit. Ti i ke bërtit atij baba, nuk e ke njoft babën tënd, e ke njoft atë. Ti, me gjithë njerëzit e tu. Me shpifje e me rrena. Ne prej vitit 1989 deri më 2007 e kemi udhëheq shtetin, po nuk kemi udhëheq me shantazhe, me rrena, me shpifje, me tradhti. Ne kemi udhëheq qysh ka hije. Qaj “baba” yt, në thonjëza, të thashë, se mos janë investimet e tij, ato janë të qeverisë, ato janë pare të popullit, për atë të thashë. Edhe mu më kanë thënë njerëzit që ti je njeri shumë i ulët. Unë kam pas respekt për ty, por kur ka qenë puna, më kanë thënë njerëzit, mos e vini Uranin se e kanë pa.. edhe ti në Blaç ke hup, se popullata jote ty s’po të dojke hiç. Se të njoftin. Unë s’të njoft mirë, as vëllai jem s’të ka njoft. I kam thënë: hej, po folin keq – qe ku është – Uranin mos e vë kryesues, për atë kam dashtë me u bo unë, mos me të lënë ty. Se e kam ditë që ti je tradhtar, se e ke tradhtue edhe vëllain tem, edhe LDK-në, edhe pushtetin ti e ke tradhtue. Ti, e jo na, të lutem! Unë nuk jam pjesë e pushtetit, as nuk konsultohem, as nuk këshillohem, por për drejtësi mu më dhemb. Sepse 1.5 milion euro Komunës ia keni marrë ju. Kontratat i ka bo qeveria, paret ia keni marrë Komunës. Turp! E dyta, zotnia i nderuar që po ma përmend emrin, ky Nedxhmidin Sejdilar. Të lutem, ti s’ke të drejtë me dalë më me replikue me mu. Ti me qëllim po ma përmendish emrin, që me dalë unë me të dhënë hapësirë me folë këtu. Të lutem, ti s’ke të drejtë me ma përmend mo emrin hiç. Po të tërheqi vërjetjen, emrin tem mo kurrë nuk e përmendish.

Uran Halimi: Kolegu në fjalë, parafolësi, në vend se me dalë edhe me kërkue falje këtu, merr edhe ma ndërron babën, thotë babë tjetër. Kjo është tepër e ulët, se unë e di veç një babë që e kam edhe në dokumentacion unë veç një babë e kam, një ish-ushtar të UÇK-së, një besnik ndaj shtetit, edhe tradhtia në familje tonë nuk ka ekzistue kurrë, i nderumi delegat. Ti mundesh me hulumtue edhe me pyet, edhe me të thënë ata që të kanë thënë se kush jam unë, po ata e dinë kush jam unë e të kanë kallxue shumë moti kush jam unë. Nëse unë kam hup në Blaç, ti ke hup në Bresanë. I bjer që qytetari të ka kallxue edhe ty kush je. Edhe unë ta kam lënë Blaçin, për me t’i marr krejt pjesë tjera. E te baba, mos delni ka baba, o vlla. Edhe te qaj baba që ti po thuesh – se babë është për ju ai, se ju rregullon krejtve.

Nedžmidin Sejdilar: I nderuar koleg, ju kam përdorur vetëm si shembull sjelljeje në kuvend. Nuk duhet të kenë standarde të dyfishta. Unë di të sillem në të gjitha situatat dhe fjalën dhe sjelljen time e përshtat me situatën dhe me njerëzit me të cilët po flas. Dua të them në mënyrë demonstrative,

nëse ju keni të drejtë të diskutoni dhe argumentet tuaja dhe të futeni në diskutime nga vendi juaj, do të bëj të njëjtën gjë. Asgjë më shumë.

Shpetim Hajredini: Ne jemi këtu për qytetarët, por tash në eventuale e pashë që debate devijoi krejt edhe doli më shumë në çështje politike, edhe individuale, sesa për atë se sa ndikon tek qytetarët, çfarë jetë kanë qytetarët dhe sa kanë punuar këta zotërinjtë për qytetarët. Po mundohen të gjithë me e marrë nga një copë të vockël nga ky projekti magjik. Po ky projekt u nis prej nesh. Tash pak kanë hise ndoshta edhe VV-ja në fund pak, por pak. Pak ka rëndësi, e rëndësishme është që ka ndikue në të mirën e qytetarëve të Dragashit. E kam thënë shumë herë, në momentin që qytetari ta jep të drejtën ty me udhëheq – në këtë ras Komunën – ti e ke obligim para qytetarëve, ti duhet me e bo më të mirën të mundshme për ta për qato katër vite, se e ke marrë ti detyrën. Edhe natyrisht që ti ke me u mundue me punue për të mirë. Nëse nuk punon, katër vite shkojnë shpejt, se shkuan katër vite, edhe qytetari ka me të ndëshkue, natyrisht. Por – më besoni – nuk mburrem me atë që e ke bo për katër vite, se e ke obligim. Edhe para Zotit – e kam thënë 100 herë – ke me dhënë llogari, edhe na qetu krejt që po i marrim qeto rrogat kena me dhënë llogari. Edhe unë jam i bindur që shumica – edhe këta të mitë edhe këtë tjerët – e dinë që 550 euro i marrim, po ne nuk e dimë ku i çojmë bile qeto pare. Unë po foli për vete, por jam i bindur që edhe ju e dini këtë. Se nuk i marrim hallall asnjëri prej nesh këtu. Kërkush hiç. Na veç vijmë këtu, më shumë mundohna me luftë, me gjujt kungja, sesa që punojmë për qytetarët e për të mirën e tyre. Tjetra, dua të lidhem pak me subvencionimin e fermerëve. I nderuar kryetar, unë e di që keni pas thirrje për subvencionimin e fermerëve për vitin që kaloi 2024. Por kam shumë informacione, prej shumë fermerëve, shumë ankesa kam që kanë bo aplikimin, kanë plotësue dokumentacionin, por paret nuk i kanë marrë. Për disa i kishit bërë pagesat, ndërsa për një pjesë të mirë të tyre nuk është bo pagesa. A do të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, apo do të zgjatet edhe më tej që ata t'i presin edhe këto shuma, që besoj janë shumë të ulëta në krahasim atë që e kemi bo na, për shembull, kur e kemi fillue subvencionim në vitin 2020. Por, së paku këto që i meritojnë, edhe këta fermerë që kanë aplikue t'i marrin. I marrin këtë muaj, apo muajin mars, apo kur keni planifikuar që të gjithë fermerët t'i marrin paret e subvencionimit, paret që atyre u takojnë. Tjetra që deshta ta diskutoj, i nderuar ekzekutiv, Rregulloren e Mbeturinave e kena votuar këtu, ju kena mbështet, edhe pse ju kam thënë që kjo Rregullore nuk është në rregull dhe nuk ka me qenë funksionale. E kam ditë 100% që ajo nuk funksionon në këtë formë, si i keni vendos çmimet dhe si keni vendos me i tatimu firmat. Por ju atëherë deshtët dhe kërkuat që ta mbështesim, se është në

rregull. Ju kam thënë se me metër katror nuk shkon dhe nuk bëhet. E keni bo me metër katror, merrni kqyrni si ju kanë ardhë faturat e janarit nga kompania. Nuk kanë të bëjnë fare me atë Rregullore që ne e kemi votue. Kryetar, kam dëgjue por edhe e kam vërejt që je i përpiktë kur vendosësh diçka me e krye. Merre edhe një herë për detyrë këtë Rregullore, sille dhe një herë në Kuvend, ta ndryshojmë dhe ta bëjmë për të mirën e bizneseve dhe qytetarëve. Lëre kompaninë çka ka dashtë me bo me to, ndoshta ata s'kanë ditë bile çka po bëhet. Nuk e di ku e kanë marrë atë shabllon. Po merre ndryshjau, e bjere këtu, po e votojmë, po e rregullojmë, edhe le të vazhdohet si ka qenë më herët. Një ndryshim i vogël na çmim, okej, është i arsyeshëm, për shkak të rritjeve që janë bo, edhe është i kuptueshëm edhe prej bizneseve, edhe prej qytetarëve në përgjithësi. Por, kjo absolutisht nuk është në rregull, edhe nuk ka me funksionue asnjëherë. Kjo ka me mbet vetëm si shënim në atë material, por nuk ka me hy në praktikë asnjëherë, dhe atë po e them me plotë kuptimin e fjalës. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush prej asambleistëve me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, para se me ta dhënë kryetar ty, është përmend shumë herë ekzekutivi dhe ka kërkuar fjalën z.Qamil Kolloni. A doni ju, apo z.Qamili? Atëherë, para se me fillue kryetari, ju kisha lut asambleistë, në qoftë se kryetari nuk ia përmend emrin asnjë asambleisti, ju lutem mos ta kërkonit të drejtën me dalë në foltore. Se në qoftë se vazhdojmë men jërin, duhet të gjithë me folë. Kështu që, para se me e marrë kryetari fjalën, ata që nuk kanë folë, ose ata që nuk kanë replikue, mundeni me e marrë. Në qoftë se kryetari ju përmend emra, atëherë jau jap të drejtën. Në qoftë se nuk ju përmendet emri, jo. Kështu që, mos ta dal unë jashtë Rregullores.

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Të nderuar të pranishëm, para se me fillue t'ju përgjigjem pyetjeve – pasi i kemi këtu mjetet e informimit dhe dje janë zhvilluar zgjedhjet nacionale – dua që në cilësinë e kryetarit të Komunës dhe në emër të qytetarëve, t'i përshëndes të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit të cilët kanë treguar një kulturë të jashtëzakonshme demokratike gjatë fushatës elektorale, e cila ka qenë një fushatë e jashtëzakonshme dhe ka kaluar pa asnjë ekces. Gjithashtu, dua t'i falënderoj qytetarët për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje dhe kulturën demokratike të treguar gjatë procesit zgjedhor. Dua të ua uroj të gjitha partive të cilat i kanë fitue këto zgjedhje – ende janë rezultate preliminare, por unë si kryetar i LDK-së këto rezultate i konsideroj si rezultate të rregullta dhe fituesve, LVV edhe PDK-së, të cilat janë dy partitë e para, iu dëshiroj suksese në të ardhmen. Por, dua të theksoj diçka. Këto nuk kanë qenë zgjedhje komunale, këto kanë qenë zgjedhje nacionale dhe popullata ka mat performancën e qeverisjes

katërvjeçare të partisë në pushtet. Kështu që, në bazë të rezultateve preliminare, del se ka një rënie të dukshme të performancës së qeverisë gjatë qeverisjes së saj katërvjeçare, diku mbi 10%. Nuk keni ngritje, mos u lavdëroni, por keni ulje të performancës dhe populli në këtë drejtim nuk jua ka dhënë atë besimin sikur që jua ka dhënë para katër viteve. Ndërsa, performancën e zgjedhjeve lokale – kur të mbahen pas 7 a 8 muajve – LDK'ja do ta tregojë pas zgjedhjeve lokale që do të mbahen. Kështu që, ka një dallim shumë të dukshëm në mes të mbajtjes së zgjedhjeve lokale edhe nacionale. LDK-ja, në këto zgjedhje nacionale ka treguar një performancë shumë më të mirë se para katër viteve dhe kemi një ngritje, afërsisht, ndoshta shkon deri në 10%. Për PDK-në nuk kam nevojë të flas, ata mund të flasin vetë.

U përmend çështja e mediave dhe pjesëmarrja e tyre në përcjelljen e seancave. Ne këto media i kemi, tjera nuk kemi. Këto media duhet t'i përcjellin seancat dhe ne këtyre duhet t'u ndihmojmë edhe financiarisht, që ata të mund të ekzistojnë. Sa i përket përcjelljes së seancës së fundit – apo e parafundit ishte, nuk po e di – të vitit të kaluar, ata të cilët dëshirojnë me e pa seancën e plotë, Radio Sharri e ka të plotë, mund ta merrni dhe ta shikoni. Ndërsa, sa i përket pse nuk ekziston pjesa e dytë e seancës në TV Opoja, unë do ta bëj një bisedë me TV Opoja, dhe në mbledhjen e ardhshme do t'ju informoj pse nuk është ajo, se unë nuk e di për çka nuk ekziston. Për ndriçimin në fshatin Rrenc, ju e dini që projektin për këtë e ka përgatit qeveria e kaluar. Ne atë projekt e kemi qit në tender dhe e kemi implementue. Ai projekt kishte pasur mangësi – tash me ose pa qëllim, e dinë ata - po ne ato mangësitë i kemi përmirësue përmes shtimit prej 10% të punimeve shtesë dhe, faktikisht, i tërë fshati Rrenc tani është i ndriçuar plotësisht. Është projekt dyvjeçar, ende nuk ka përfundue, edhe pagesa e tërësishme ende nuk është bo. Kështu që, ditët në vijim punëkryesi duhet t'i përfundojë të gjitha punimet që kanë mbet, edhe fshati Rrenc do të jetë tërësisht i ndriçuar. U tha se gjatë zgjedhjeve lokale janë terrorizue edhe janë blerë vota. Nuk është e vërtetë. Qytetarët nuk janë terrorizuar gjatë procesit të zgjedhjeve. Nëse ka dikush ndonjë informatë që janë terrorizue, janë organet, le t'i paraqesin. Ndërsa, sa i përket LDK-së, ne nuk kemi blerë vota, sepse po të kishim blerë vota ne do të kishim dalë të parët. Kjo është logjike. Sa u përket disa projekteve në fshatin Bresanë, u përfolën edhe shumë kubëzime, në fshatin Bresanë nuk janë bërë pagesa e tërësishme e projekteve. Kubëzimet në fshatin Bresanë janë projekte dyvjeçare. Edhe nuk është e vërtetë – nuk e di a nuk po din me lexue ti, apo nuk po kupton, apo nuk po i din numrat – nuk është bo pagesa e investimeve kapitale sa u përket kubëzimeve në fshatin Bresanë. Sa u përket atyre mbrojtëseve të borës, ato kanë qenë të vendosura por sigurisht kanë qenë të kualitetit të dobët dhe

bora e madhe që ka ra i ka shkulë nga vendi. Tash i kemi vendos të reja. Shtëpia malore ka qenë projekt njëvjeçar, ashtu siç kanë qenë në tender u përfundue tërësisht edhe u krye pagesa. U përmend Statuti i QKMF-së. U bo shumë polemikë për këtë Statut, nuk po më vjen mirë që zv/kryesuesi nuk është këtu. Ai ka bërë atë ditë skandale, edhe me kryesuesen është sjellë jashtëzakonisht keq, është dashtë t'i kërkojë falje. Gjithashtu, ai ka bërë edhe thirrje për përçarje në mes të popullatës shqiptare dhe komunitetit joshumicë. Në bashkëpunim edhe me tjerët. Për fatë të mirë, ne jemi një qeveri demokratike dhe nuk u nënshtrohemi këtyre thirrjeve dhe përçarjeve. Ju e dini që Statutin e ka miratue Asambleja Komunale dhe qeveria ka prurë vërejtje që njëri prej neneve të cilin ne e kemi miratuar nuk është i bazuar në ligj. Kjo Asamble ka votue dhe e ka anulue atë nen. Mirëpo, dobia më e madhe e jona ka qenë sepse ne kemi arrit që në Statutin e QKMF-së, që ta kemi edhe një zv/drejtor. Tani me Statutin e ri ekziston pozita e zv/drejtorit të QKMF-së. Tani neve na është kthye ky Statut i ligjshëm, pasi Asambleja e ka miratue. Dhe kur është kthye i ligjshëm, pas 15 ditësh që ka hy në fuqi, unë e kam emëruë zv/drejtoreshën, një grua e nacionalitetit goran. Arsyeja pse e kam emëruë atë është sepse unë dua që ta avancoj pozitën e femrës në shoqërinë tonë në Komunë. Njëra prej arsyeve ka qenë kjo dhe e dyta ka qenë arsyeja ligjore, sepse në Statutin e QKMF-së tashmë është e regjistruar që QKMF-ja duhet të ketë edhe zv/drejtorin/eshën. Janë të kota thirrjet e të ashtuquajturit asambleist, i cili me pa të drejtë del në foltore edhe flet në emër të goranëve. Ai nuk është përfaqësues i goranëve, ai me 200 vota nuk mund me qenë përfaqësues i komunitetit goran. Unë si kryetar i Komunës, që nga viti 1980, si mjek, i njoh shumë mirë komunitetin goran dhe kam një respekt të jashtëzakonshëm për ta. Unë si qytetar dhe kryetar i Komunës, të gjitha komunitetet që jetojnë në Komunën e Dragashit i trajtoj të njëjtë dhe të barabartë, dhe ata të gjithë janë të barabartë para ligjit. Sa u përket investimeve në fshatin Zym, unë – i nderuar Nexhat – në seancën e ardhshme do t'i marr të gjitha shënimet, sa mjete janë investue në fshatin Zym, nuk janë të sakta për shifrat që i përmende. Ka shumë ma shumë sesa që i përmendet ju, por saktësisht në mbledhjen e ardhshme, ose në pikën e ndryshme apo në një pikë tjetër, unë do ta bie shifrën e saktë të mjeteve që janë investue në fshatin Zym, prej vitit 2023-2024. Sa u përket subvencionimit të pagesave, të gjithë bujqit i kanë marrë vendimet dhe është bërë lista e subvencionimit dhe, sapo të lirohen pagesat edhe na lëshohen mjetet nga të hyrat vetanake, të gjithë atyre që nuk u janë pague do t'u paguhen. Sigurisht deri kah muaji i tretë iu paguhen të gjithëve. Sa i përket Rregullores së Mbeturinave, unë nuk po dua të bëj politikë me këtë Rregullore, kjo një herë është miratue dhe tash, nga muaji janar, ka fillue që të zbatohet. Nëse

gjatë rrugës do të ketë mangësi edhe probleme, pse jo, ne mund ta biem edhe në Asamble dhe ta shqyrtojmë edhe një herë. Mirëpo, me sa e di unë, kjo Rregullore ka has në mirëkuptim te qytetarët, sidomos te ekonomitë familjare, sepse rritja është bo vetëm prej 1 euro dhe qytetarët janë të kënaqur me këtë. Po megjithatë, ne jemi të hapur për çdo propozim që vjen, edhe nga pozita edhe nga opozita, edhe nga shoqëria civile, ne mund ta debatojmë këtë në një mbledhje të ardhshme të Asamblesë. Unë nuk jam kundër kësaj. Ndoshta të gjithëve ju përgjigja në pyetjet që i bëtë, por nëse kam harruar dikujt t'i përgjigjem, këtë mund ta bëjmë në seancën e ardhshme.

Nexhat Selaj: Kryetar, derisa nuk e ke shikue sa para janë ndarë dhe sa janë investuar, nuk ishte e mirë të thuash nuk është e saktë. Derisa nuk e ke vërejt sa para për 2023-tën dhe 2024-tën janë ndarë, edhe derisa nuk e ke vërejt sa janë investue, m'u drejtove, thaje nuk është e saktë kjo, të jesh pak më vigjilent kur të japësh këso përgjigje, se kjo është më se e saktë. Pavarësisht nga ajo, unë do të kërkoj që në seancën tjetër prapë të shikojmë 2024-tën, paratë e ndara për fshatin dhe të investuara. 8 mijë euro i ke në shënime, unë u bazova nga ajo çfarë pashë në shpenzimet e vitit 2024, 8 mijë euro shpenzime për urën në Qollopek. E ke me shifër, ta gjej me shifër. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, ju kisha lut, nuk ka replika asnjë. Është përmend që në fshatin Rrenc janë 50 vota dhe ka rënie LDK-ja. Para katër viteve në zgjedhjet nacionale 17 vota i ka pas LDK-ja. Tash i ka 50. Ngritje ka LDK-ja. Kush ka rënie, le ta kqyre. M'u kërkua nga unë që të bëj një kërkimfalje. Unë nuk e kam zakon me bo shumë kërkimfalje, i bëj veç atij që e rëndoj vetë. Në qoftë se dikush mu më bën presion, edhe unë ia kthej në të njëjtën monedhë. Atëherë, ju kisha lut mediave dhe të gjithë të pranishmëve në sallë, përveç asambleistëve të cilët duhet të mbesin në sallë, të tjerët le të na lëshojnë sallën. E kemi një diskutim për punën e Kuvendit. Ju faleminderit!